



Shkolla “Ernest Koliqi”



PËRGJEGJËSI dhe DIJE

www.ernestkoliqi.com | info@ernestkoliqi.com | +355682000767





“ Ne kemi marrë nga shkollat më të mira franceze disa parime të thjeshta dhe të testuara prej shekujsh: punën sistematike, mendimin kritik e analitik si dhe dëshirën për të tejkaluar veten në çdo çast. ”

Jean-Pierre Le Goff
President



“ Të gjithë flasim shpesh për problemet që hasen në shkollat tona publike apo private.

Gjithmonë më ka mundur pyetja: *“Vërtet është kaq e vështirë të bësh një shkollë model?”*

Pas një experience të gjatë në mësimdhënie dhe drejtim në shkollat publike, unë jam tashmë pjesë e stafit drejtues të shkollës “Ernest Koliqi”, për t’i dhënë vetes time dhe të gjithë atyre që i mundon e njëjta pyetje, një përgjigje të thjeshtë. Me ide të qarta, profesionalizëm, rigorozitet dhe përkushtim, një shkollë model është plotësisht e mundur.



Mirela Berisha
Drejtore





Ermal Hasimja
Administrator

“ Qëllimi ynë madhor është t’i përgatisim nxënësit për universitetet perëndimore dhe për jetën profesionale. Prandaj më tepër sesa lëndët në vetvete ne punojmë për të rrënjosur te nxënësit edukatën e punës dhe përgjegjshmërinë ndaj vetes. Shkolla nuk është as kënd lojërash e as burg, por një institucion parapërgatitor për jetën reale. Nëse synon të jetosh më mirë se të tjerët, duhet të punosh më fort se të tjerët.



MISIONI I SHKOLLËS

- Të rrënjosë te nxënësit mendësinë dhe edukatën e punës përmes kërkesës së lartë dhe rigorozitetit në vlerësim.
- Të përgatisë nxënësit për universitetet më të mira perëndimore.
- Të kultivojë frymën e përgjegjësisë ndaj vetes.
- Të edukojë qytetarë të përgjegjshëm dhe të angazhuar.
- Të nxisë mendimin kritik dhe aftësitë analitike.





FILOZOFIA E SHKOLLËS

Ne mendojmë se arma më e dobishme për të ardhmen e të rinjve është mendësia e punës dhe përgjegjshmërisë ndaj vetes. Shkolla jonë kultivon këtë mendësi përmes shmangies së fiktivitetit në vlerësim, kërkesës së lartë ndaj nxënësit dhe ofrimit të cilësisë maksimale të mësimdhënies dhe përkushtimit të një stafi prej rreth 90 vetësh.

Ne mendojmë se më shumë sesa njohuritë në fizikë, kimi apo gjeografi nxënësit duhet të jenë të zotët e vetes dhe të aftë psikologjikisht për të përballuar kërkesat e universiteteve perëndimore, por edhe të tregut të punës.

Kjo nuk është një shkollë për nxënës dembelë e të llastuar. Por është mjedisi ideal për çdo nxënës që synon të marrë maksimumin nga shkolla. Për këtë kemi mbledhur një staf të kualifikuar e të përkushtuar, kemi ndërtuar një program mësimor të përshtatur me kërkesat e universiteteve perëndimore dhe kemi siguruar një infrastrukturë moderne e funksionale







AKTIVITETET

“Ernest Koliqi” nuk njihet vetëm për cilësinë dhe nivelin e shkollimit, por edhe për aktivitetet jashtëshkollore.

Ekskursionet tona synojnë jo vetëm të argëtojnë nxënësit, por edhe t’u zgjerojnë horizontin kulturor.





ADMINISTRATA

President – **Jean-Pierre Le Goff**

Drejtoreshë – **Mirela Berisha**

Administrator – **Ermal Hasimja**

Sekretaria – **Anisa Greva**

DEPARTAMENTET

Parashkollori dhe 9-vjeçarja

Departamenti i Ciklit Fillor – **Elona Xhemali**

Departamenti i Shkencave Shoqërore – **Najada Grykshi**

Departamenti i Shkencave Natyrore – **Klodiana Jaupaj**

Departamenti i Sporteve – **Ornela Doda**

Departamenti i IT-së – **Gjergji Kokushta**

Gjimnazi

Departamenti i Gjuhës dhe biblioteka – **Mimoza Verzivolli**

Departamenti i Shkencave Shoqërore – **Orikela Ndreçka**

Departamenti i Shkencave Natyrore – **Klea Mineu**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja – **Elissa Thorne**



REGJISTRIMI DHE TRANSFERIMI

Procedura e regjistrimit, afatet dhe testi paraprak

Regjistrimi ose transferimi në shkollë bëhet vetëm pas kalimit me sukses të një testi në gjuhë/letërsi dhe matematikë. Moskalimi i testit pamundëson regjistrimin, pavarësisht mesatares së nxënësit në shkollën e mëparëshme.

Nxënës me probleme disiplinore e sjelljeje në shkolla të tjera nuk pranohen.

Vendet e lira janë të kufizuara. Me plotësimin e numrit të 16 nxënësve në klasë për klasat e parashikuara regjistrimet mbyllen.

Testet zhvillohen në çdo kohë me një njoftim të thjeshtë paraprak të sekretarisë:

Anisa Greva: 0682000767.

TARIFAT E SHKOLLËS

Tarifat e shkollës gjenden në faqen zyrtare:

<http://www.ernestkoliqi.com/regjistrimi-dhe-tarifat.php>

SHËNIM:

1. Për nxënës nga e njëjta familje zbatohet një zbritje prej 25% për secilin të tarifa e shkollës.
2. Transporti dhe ushqimi janë opsionale. Nëse nuk përdoren, nuk paguhen.

BURSAT

Shkolla ofron bursa studimi për nxënësit që nisin klasën e 10 përmes një konkursi që zhvillohet në fillim të pranverës. Njoftimi botohet në faqen e shkollës si dhe në Facebook. Këto bursa mbulojnë tarifën e shkollës.

Bursa jepet për 3 vitet e gjimnazit me kushtin e ruajtjes së mesatares mbi 9,7. Deri më sot asnjë bursë nuk është ndërprerë dhe të gjithë bursistët kanë ruajtur bursat me sukses.

Për informacione të tjera:

e-mail: info@ernestkoliqi.com

Celular: **0682000767**



Këshillimi dhe studimet jashtë vendit

Shkolla ndihmon dhe këshillon maturantët në zgjedhjen e universitetit përmes një procesi diskutimi e mentorimi të vazhdueshëm që nis që nga klasa e 11. Ky proces synjon të ndihmojë e qartësojë nxënësit në përzgjedhjen e degës dhe të vendit të studimit. Gjithashtu stafi i shkollës përgatit letrat e rekomandimit dhe çdo dokument tjetër të kërkuar në anglisht ose frëngjisht sipas universitetit ku maturanti aplikon.



Shkolla “Ernest Koliqi”

Rruga Dardania, nr. 25, Katund i ri, Kashar, Tiranë
www.ernestkoliqi.com | info@ernestkoliqi.com | +355682000767

